



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 198 Akti

**Nr. 206 Vendimi
Tiranë, më 7.11.2019**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine
Valbona Sanxhaktari
Roland Ilia

Kryesuese
Relatore
Anëtar

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në datën 4.11.2019, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Brunilda Malo (Orhani), gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen mbështetur në nenin 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N :

1. Znj. Brunilda Malo është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Malo, u shortua në datën 17.9.2018. Relatore e çështjes u zgjodh sipas shortit komisionere Valbona Sanxhaktari dhe anëtarë komisionerët Xhensila

- Pine dhe Roland Ilija. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtarën Xhensila Pine. Vëzhguese ndërkombëtare për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.
3. Në datën 23.9.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjykuese.
 4. Në datën 28.1.2019, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
 5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
 6. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
 7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura për kriterin e pasurisë në datën 29.7.2019, vendosi mbylljen e hetimit kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë, për subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Malo dhe mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
 8. Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Malo, me *e-mail*-in e datës 29.7.2019, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të paraqitura nga Komisioni.
 9. Në datën 31 korrik 2019, subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike kërkesën për shtyrjen e afatit të caktuar nga Komisioni për një datë tjetër pas datës 9 shtator 2019, dhe kërkesën për vazhdimin e hetimit administrativ edhe për të dyja kriteret e tjera të parashikuara nga ligji.
 10. Komisioni, pasi vlerësoi kërkesën e subjektit për shtyrje të afatit pas datës 9 shtator 2019, në vlerësim të shkaqeve të paraqitura, ka njoftuar subjektin se nuk e pranon kërkesën për shtyrjen e afatit.
 11. Lidhur me kërkesën për vazhdimin e hetimit administrativ nga Komisioni edhe për të dyja kriteret e tjera të parashikuara nga ligji, ka informuar znj. Brunilda Malo se deri në këtë fazë të hetimit Komisioni ka konstatuar problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat kanë nivelin e provueshmërisë sipas ligjit dhe subjekti duhet të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit.
 12. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe në datën 22 gusht 2019 dërgoi me anë të postës elektronike një kërkesë tjetër për shtyrjen e afatit për paraqitjen e shpjegimeve, për arsye shëndetësore.
 13. Komisioni, pasi vlerësoi kërkesën në raport me shkaqet e paraqitura, ka njoftuar znj. Brunilda Malo se e ka pranuar atë, duke shtyrë afatin e paraqitjes së shpjegimeve nga 26.8.2019 për më 9.9.2019.

14. Subjekti i rivlerësimit paraqiti në datën 9.9.2019 kundërshtimet dhe provat e saj për gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit, së bashku me to subjekti ka paraqitur edhe kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ.

15. Komisioni ka pranuar të gjitha shpjegimet e subjektit dhe ka administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura prej saj, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit në datën 1.10.2019 lidhur me vendimin e marrë për refuzimin e disa provave me dëshmitarë dhe kërkesave për këqyrje, si dhe mospranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit me argumentimin përkatës. Në vijim, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Malo, në seancë dëgjimore në datën 3.10.2019.

16. Subjekti i rivlerësimit u paraqit në datën 3.10.2019, në seancën dëgjimore dhe në fillim të saj paraqiti pranë trupit gjykues kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, si dhe vazhdimin e hetimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale.

17. Trupi gjykues, pasi u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, vendosi të mos e pranojë, duke vazhduar me seancën dëgjimore dhe duke i dhënë mundësinë subjektit për të dhënë shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit.

18. Subjekti, pasi u njoh me vendimin e trupit gjykues, vijoi me kërkesën e saj për përjashtimin e trupit gjykues të përbërë nga: Xhensila Pine kryesuese; Valbona Sanxhaktari relatore; dhe Roland Ilija anëtar, nga gjykimi çështjes, pasi subjekti ka krijuar bindjen se vendimi është i paragykuar dhe se seanca është thjesht një formalitet për dëgjuesin e publikut, por jo për të realizuar të drejtat e subjektit parashikuar në ligjin nr. 84/2016, në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

19. Trupi gjykues pasi u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e këtij trupit gjykues, vendosi të ndërpresë seancën dëgjimore dhe ta paraqesë kërkesën e subjektit të rivlerësimit pranë një trupe tjetër gjykuese që do të zgjidhet me short e cila do ta vlerësojë dhe do të shprehet për këtë kërkesë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

20. Me vendimin nr. 43, datë 3.10.2019, mbledhja e Komisionit, vendosi ngritjen e trupit gjykues për shqyrtimin e kërkesës së znj. Brunilda Malo për përjashtimin e trupit gjykues.

21. Trupi gjykues i miratuar me vendimin nr. 43, datë 3.10.2019, në përfundim, vendosi të rrëzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Malo, për përjashtimin e trupit gjykues si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe të njoftojë subjektin për këtë vendim.

22. Komisioni njoftoi në datën 9.10.2019, subjektin e rivlerësimit për vijimin e seancës dëgjimore në datën 21.10.2019.

23. Subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike në datën 10.10.2019 kërkesë për shtyrjen e datës së seancës dëgjimore për një datë tjetër, duke paraqitur edhe shkaqet lidhur me këtë kërkesë.

24. Komisioni, pasi vlerësoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, e pranoi atë, duke caktuar seancën dëgjimore në vijim në datën 4.11.2019, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

25. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.11.2019, ora 12:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

26. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht e shpjegoi lidhur me rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni dhe barrën e provës. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi që të riçeljet hetimi administrativ, të vlerësohen dy kriteret e tjera, si dhe të rivlerësohet kriteri i pasurisë mbi bazën e provave dhe çfarë rezultatesh kanë sjellë provat e subjektit në vlerësimin e Komisionit për këtë kriter.

27. Trupi gjykues, pasi dëgjoji subjektin në seancën dëgjimore publike të datës 4.11.2019, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, vlerësoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti dhe në vijim të rezultateve të hetimit arrin në përfundimin se provat e administruara nga Komisioni për kriterin e pasurisë arritën nivelin e provueshmërisë dhe se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për disa prej tyre.

28. Trupi gjykues, referuar parashikimeve të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, “Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”, si dhe vendimit nr. 3, datë 17.7.2018, të Kolegjit të Apelit, pika 16, e seksionit III, vlerëson se kur provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendimi mund të merret edhe bazuar vetëm në një prej kriterëve të vlerësimit.

29. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Malo, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe të vlerësimit profesional.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

30. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit Brunilda Malo, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të pasurive nga aktiviteti privat i bashkëshortit;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë ndër vite;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

31. Pavarësisht se sipas Kreu IV të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoritet përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit¹, Komisioni, mund dhe duhet të kryejë një hetim të thelluar.

RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

32. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri.

33. Apartament banimi me sip. 73.8 m², ndodhur në qytetin e Korçës, regjistruar në ZVRPP-në Korçë, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, blerë nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 7.7.2007, në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë. Zotërimi është 50 %. Kjo pasuri është deklaruar edhe në deklaratën e interesave privatë periodik/vjetor të vitit 2007. Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat dhe nga aktiviteti privat i bashkëshortit të subjektit.

33.1 ZVRPP-ja Korçë konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj, z. A. M., figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 73.78 m², me nr. ***, z.k. ***, në bashkëpronësi me 1/2 pjesë të pandarë.

¹ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi.”

33.2 Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 7.7.2007, subjekti dhe bashkëshorti i saj blejnë apartamentin e mësipërm nga shtetasi M. K., në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale, ndërsa në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti e ka deklaruar këtë pasurinë në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë.

33.3 Subjekti shpjegon se ndryshimi midis çmimit 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë të përcaktuar në kontratë dhe vlerës 4.000.000 (katër milionë) lekë të deklaruar, qëndron në faktin se në momentin e përpilimit të kontratës kishte ende punime të pakryera në apartament. Diferenca në vlerën 2.300.000 (dy milionë e treqind mijë) lekë përfshin punimet e kryera në apartament, si dhe vlerën e mobilimit të tij, prandaj vlera e deklaruar 4.000.000 (katër milionë) lekë përfaqëson çmimin real të apartamentit. Subjekti e ka konfirmuar këtë fakt edhe përpara ILDKPKI-së në vitin 2015².

33.4 Burim të krijimit të kësaj pasurie, sipas deklarimeve të subjektit, janë të ardhura nga pagat dhe nga aktiviteti privat i bashkëshortit, por pa specifikuar vlerat përkatësisht. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës “Vetting”:

- ekstraktin historik të shoqërisë “***” sh.p.k., datë 27.10.2016³;
- informacionin e marrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për fitimet e shoqërisë për periudhën 2002 – 2013; dhe
- të tjera akte⁴ lidhur me aktivitetin privat të bashkëshortit të subjektit.

33.5 Nga hetimi i Komisionit lidhur me aktivitetin privat të bashkëshortit të subjektit, z. A. M., Qendra Kombëtare e Biznesit⁵ konfirmon regjistrimin e shoqërisë “***” sh.p.k., me vendim nr. ***, datë 13.2.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “aktivitet në fushën e ndërtimeve publike etj”. Bashkëshorti i subjektit fillimisht rezulton ortak i vetëm në shoqëri dhe në vijim si bashkëpronar me përqindje të ndryshme takuese në kapital deri në vitin 2012, dhe më pas në datën 24.1.2013, i shet kuotat e tij tek ortakët e tjerë.

33.6 Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, informon se shoqëria ka deklaruar për herë të parë qarkullim vjetor dhe fitim në vitin 2009, i cili ka vazhduar deri në vitin 2012. Por nuk ka të dhëna për shpërndarje të dividendit dhe për pagesën e tatimit mbi dividendin për këtë shoqëri.

33.7 **Nga hetimi ka rezultuar se subjekti:** (1) nuk ka deklaruar përkatësisht vlerën sipas burimeve të përdorura, të deklaruara, për blerjen e apartamentit dhe as vlerën e saktë të përdorur nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit; (2) nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues lidhur me të ardhurat e përfituara nga biznesi privat i bashkëshortit, si dhe vlerën e përfituar.

33.8 Kjo pasuri është paraqitur në analizën financiare të Komisionit me vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë.

34. Ambient “bar-kafe” me sip. 90 m², nr. pasurie *, z.k ***, ndodhur në qytetin e ***, blerë në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, në datën 2.4.2014 nëpërmjet ankandit të përmbauesit P. T. Vendim nr. *** regjistri, datë 30.4.2014, për kalimin në pronësi të sendit me zotërim 100 %, të bashkëshortit të subjektit . Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe aktiviteti privat i bashkëshortit.**

34.1 Nga informacioni i ardhur nga “Raiffeisen Bank”⁶ rezulton se në datën 23.12.2008 janë lidhur dy kontrata kredie bankare midis shoqërisë “***” dhe “Raiffeisen Bank”, me nr. *** dhe me nr. ***, me objekt “marrjen e kredive në një vlerë totale prej 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro me qëllim financim për kapital punues dhe për blerjen e kafshëve të prodhimit”.

² Shkresa nr. *** prot., datë 27.6.2019, e ILDKPKI-së, procesverbali datë 2.3.2015, përgjigja nr. 7.

³ Shihni dosjen e ILDKPKI-së, ref. 4/2.

⁴ Vërtetime për vitet 2005, 2006 për fitimet e realizuara nga shoqëria; aktekspertizë datë 24.6.2005, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë (dosje ILDKPKI).

⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 6.2.2019, e QKB-së.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2019.

34.2 Për sigurimin e këtyre kredive ka shërbyer pasuria e llojit “truall dhe ndërtesë”, me sip. 149 m² me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, me nr. regj. ***, datë 24.12.1996, e ndodhur në sheshin “****”, ***, Kolonjë, në pronësi të shtetasve M., dhe A. M., sipas kontratës së hipotekës me nr. ***, datë 23.12.2008.

34.3 Për shkak të mosshlyerjes së kredisë “Raiffeisen Bank” ka nisur procedurat e ekzekutimit, ka ndarë pasurinë e lënë hipotekë në dy pjesë, ku pjesa e pasurisë, “bar-kafe”, me sip. 90 m², dhe trualli nën të, me nr. pasurie ***, ndodhur në z.k. ***, i është nënshtruar procedurave përmbarimore, ku në përfundim të tyre, pasuria i ka kaluar ofertuesit të vetëm, z. A. M., bashkëshorti i subjektit, me vendim “mbi kalimin në pronësi të sendit të paluajtshëm shitur në ankand” me nr. *** regjistri, datë 30.4.2014, në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, nga e cila në favor të bankës ka kaluar vlera 1.679.600 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë.

34.4 Gjatë hetimit administrativ të kryer konfirmohet pagesa e vlerës 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë për blerjen e kësaj pasurie, nëpërmjet transfertave bankare nga llogaria e bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”, përkatësisht në datat 2.4.2014 dhe 16.4.2014.

34.5 Qendra Kombëtare e Biznesit informon se shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***, është themeluar në datën 12.6.2007, nga shtetasit M. M., (51 %) dhe A. M., (49 %) dhe në datën 9.5.2008 ortaku A. M., është larguar nga shoqëria. Nga hetimi rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka pasur lidhje me këtë shoqëri në vitin 2007, por në kohën e lidhjes së kontratës së kredisë nuk ka qenë më ortak i kësaj shoqërie.

34.6 Nga ZVRPP-ja Kolonjë konfirmohet regjistrimi i pasurisë në emër të bashkëshortit të subjektit mbi bazën e vendimit të përmbaruesit gjyqësor të sipërcituar, pasuri e cila pas vdekjes së tij⁷, me çeljen e trashëgimisë, ka kaluar në pronësi të subjektit dhe të dy vajzave të saj me nga 1/3 pjesë takuese.

34.7 Burim për blerjen e kësaj pasurie sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën “Vetting” kanë shërbyer të ardhurat nga pagat dhe nga aktiviteti privat i bashkëshortit.

34.8 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti ka deklaruar si burim për fitimin e pasurisë: (1) të ardhura nga pagat; (2) përdorimi i *overdraftit*; (3) të ardhura nga ekzekutimi pjesor i detyrimit për shkak të shitjes së kuotave të kapitalit në shoqërinë “****” sh.p.k., pa specifikuar vlerën; (4) dhuratë në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë nga i ati i bashkëshortit të subjektit, z. M. M., transferuar në llogarinë bankare, nr. ***, të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”; (5) dhuratë në vlerën 190.000 (njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë nga vëllai i bashkëshortit të subjektit, z. A. M., transferuar në llogarinë, nr. ***, të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”.

34.9 Gjatë hetimit administrativ u konfirmua transferimi i vlerës nga shtetasi M. M., në datën 8.4.2014 në llogarinë bankare të deklaruar nga subjekti. Gjithashtu, u konfirmua transferimi i vlerës 19.600 (nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë në datën 16.6.2014 në llogarinë bankare të bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, por nuk identifikohet dërguesi i vlerës.

a) Për sa i përket burimit të të ardhurave të babait të bashkëshortit, z. M. M., subjekti deklaroi se ai ka pasur të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit “bar-kafe”, i sekuestruar dhe më pas i riblerë në vitin 2014; të ardhura nga shoqëria “****” sh.p.k.; si dhe nga pensioni i pleqërisë së tij dhe bashkëshortes.

Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni⁸ rezultoi se shtetasi M. M., ka pasur të reregjistruar aktivitetin “bar-kafe”, me NIPT ***, me aktivitet në periudhën 1.1.2003 – 30.4.2010.

⁷ Me aktin e vdekjes nr. ***, datë 30.9.2016.

⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.2.2019; vërtetim nr. *** prot., datë 5.3.2017; dhe vërtetimi nr. *** prot., datë 27.5.2019 nga DRT-ja Korçë.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë informon se kjo shoqëri ka pasur aktivitet tregtar në periudhën 10.7.2007 – 7.6.2012, dhe ka realizuar fitime në vlerën totale 3.980.169 (tre milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë në vitet 2009 – 2010, por nga ana tjetër nuk provohet shpërndarja e dividendit dhe pagesa e tatimit mbi dividendin për këtë shoqëri.

b) Për sa i përket burimit të të ardhurave të shtetasit A. M., subjekti ka deklaruar se janë të ardhurat nga: emigracioni në Londër që nga viti 1997 deri në vitin 2004; të ardhurat nga paga si punonjës në “Bankën Popullore” me pagë mujore 200.000 (dyqind mijë) lekë/muaj; të ardhurat nga paga si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., që nga viti 2007 e në vijim; si dhe të ardhurat e bashkëshortes znj. E. M., e punësuar si administratore e Fondacionit “****”, me pagë mujore 100.000 (njëqind mijë) lekë/muaj. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të ardhurat e sipërpërmendura, përveç vërtetimit të pensioneve të pleqërisë të prindërve të bashkëshortit.

34.10 Nga hetimi ka rezultuar se: (1) ka mospërputhje midis burimeve të krijimit të kësaj pasurie të deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe atyre të deklaruara në deklaratën e interesave privatë periodik/vjetor të vitit 2014; (2) subjekti nuk ka deklaruar përkatësisht vlerat sipas burimeve përkatëse të përdorura, të deklaruara për blerjen e pasurisë.

34.11 Kjo pasuri është pasqyruar në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni.

35. Tokë bujqësore me sip. 2.670 m², marrë me qira për 25 vjet, me kontratë nr. *, parapaguar vlera e qirasë 110.000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë.** Subjekti ka paraqitur kontratën e qirasë nr. ***, datë 18.11.2015, sipas të cilës bashkëshorti i saj ka marrë me qira tokën bujqësore me sip. 2.670 m², në fshatin ***, Kolonjë, nga shtetasi F. M. I., kundrejt qirasë në vlerën 110.000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë, për një periudhë 25-vjeçare, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga e bashkëshortit, me zotërim 100 % nga bashkëshorti i subjektit.

35.1 Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie dhe investimin e mundshëm të kryer, në pyetësorin nr. 2⁹, deklaroi se kjo tokë është marrë me qira nga bashkëshorti i saj me qëllim kultivimin e kulturave bujqësore ose frutore, por ai nuk ka kryer asnjë investim për shkak të angazhimit të tij si Kryetar i Bashkisë Kolonjë¹⁰ në atë periudhë. Aktualisht kjo tokë përdoret nga babai i bashkëshortit të subjektit, z. M. M., pasi ndodhet në fshatin e tij, ***¹¹, Kolonjë.

35.2 Shpjegimet e subjektit duken bindëse dhe në koherencë me dokumentacionin e administruar. Kjo pasuri është pasqyruar në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni.

36. Automjet tip “Mitsubishi”, vit prodhimi 1998, blerë në vitin 2003, me vlerë 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, me targa *, regjistruar pranë Drejtorisë së Automjeteve Korçë.** Burimi i krijimit: të ardhura nga paga me zotërim 100 % nga subjekti.

36.1 DPSHTRR-ja konfirmon se subjekti e ka blerë automjetin nëpërmjet kontratës së shitblerjes datë 19.12.2003, nga shtetasi A. K., në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, e likuiduar në prani të noterit.

36.2 Subjekti ka shitur automjetin me kontratë shitblerje në datën 14.4.2017, shtetasit P.H., në vlerën 380.000 (treqind e tetëdhjetë mijë) lekë, e likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale. Kjo vlerë është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017 dhe është pasqyruar në seksionin e të ardhurave të analizës financiare të vitit 2017.

⁹ Pyetësori nr. 2, përgjigje nr. 3.

¹⁰ Konfirmohet emërimi i bashkëshortit të subjektit si kryetar i Bashkisë Kolonjë në korrik të vitit 2015, nga vërtetimi i paraqitur nga subjekti në ILDKPKI.

¹¹ Konfirmohet vendlindja e z. M. M., në ***, Kolonjë, sipas regjistrimit të Gjendjes Civile.

36.3 Përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje. Kjo pasuri është pasqyruar edhe në analizën financiare të vitit 2003, në seksionin e pasurive.

37. Automjet tip “Volkswagen”, vit prodhimi 2006, me vlerë 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, me targa *, regjistruar pranë Drejtorisë së Automjeteve Korçë. Burimi i krijimit: të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit, me zotërim 100 % të bashkëshortit të subjektit.**

37.1 Sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni rezulton se ky automjet është blerë nga bashkëshorti i subjektit, z. A. M., te shoqëria “****” sh.p.k., nëpërmjet faturës tatimore nr. ***, datë 3.3.2006, me nr. serial ***, në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro (ose 1.845.000 ‘një milion e tetëqind e dyzetë e pesë mijë’ lekë), e cila është përfshirë në analizën financiare të vitit 2006, te seksioni i pasurive.

37.2 Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion provues lidhur me mundësitë financiare dhe me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Znj. Brunilda Malo deklaroi¹² se burimet e blerjes së këtij automjeti janë si vijon:

a) të ardhura të krijuara nga bashkëshorti i subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k., në vitet 2003, 2004 dhe 2005 (burimi kryesor);

b) dëmshpërblim i përfituar nga kompania e sigurimit “****”, në vlerën 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si pasojë e dëmtimit të automjetit tip “Nissan”, të reregjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. Sigurimi i këtij automjeti është bërë në emër të subjektit të rivlerësimit, prandaj edhe vlera e dëmshpërblimit është përfituar nga vetë ajo, duke kryer tërheqjen e kësaj vlerë nga “Tirana Bank”¹³;

c) shitje e automjetit, tip “Nissan” (automjeti i dëmtuar gjatë aksidentit), në vlerën 3.000 (tre mijë) euro, në datën 1.9.2006, nga shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori A. M., te shtetasja V. H.

Subjekti i ka konfirmuar këto tri burime edhe përpara ILDKPKI-së në datën 2.3.2015¹⁴.

37.3 Subjekti ka paraqitur një vërtetim¹⁵ ku shoqëria “****” sh.p.k., informon se automjeti tip “Nissan” është blerë nga kjo shoqëri në vitin 2004, kur z. A.M., ka qenë administrator dhe ortak i vetëm i saj. Në vitin 2005 ky mjet është nxjerrë nga qarkullimi dhe veprimet që janë kryer më pas me mjetin e dëmtuar nuk kanë qenë në interesat e shoqërisë dhe vlera e kontratës së shiteshës nuk është derdhur asnjëherë në arkën e shoqërisë.

37.4 Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k., në vitet 2003, 2004 dhe 2005, rezulton se bashkëshorti i subjektit, z. A.M., nuk ka përfituar të ardhura nga dividendi në cilësinë e ortakut të shoqërisë “****” sh.p.k. Nga dokumentacioni i administruar nuk konfirmohet shpërndarje dividendi të kësaj shoqërie. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë informon se nuk disponon të dhëna për dividend të derdhur nga shoqëria për vitet ushtrimore 2002-2012. Shoqëria “****” sh.p.k, sipas informacionit nga Qendra Kombëtare e Biznesit¹⁶, ka kryer zmadhimin e kapitalit të saj, duke përdorur fitimet e realizuara gjatë viteve 1997 – 2004.

37.5 Nga hetimi ka rezultuar se: (1) ka mospërputhje midis burimeve të krijimit të kësaj pasurie të deklaruar në deklaratën “Vetting”, në deklaratën e interesave privatë periodik/vjetor të vitit 2006 dhe atyre të deklaruar në ILDKPKI në datën 2.3.2015, si dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni; (2) subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të justifikuar krijimin e të ardhurave të ligjshme nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo pasuri është pasqyruar në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni.

38. Depozitë nr. *, transferuar nga depozita nr. ***, hapur në datën 12.3.2009, në “Credins Bank”. Në deklaratën “Vetting” është deklaruar vlera 39.379 (tridhjetë e nëntë mijë e treqind**

¹² Pyetësori nr. 4, përgjigja nr. 1

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.5.2019, nga kompania “****”.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2019, përgjigja nr. 6.

¹⁵ Vërtetim datë 2.9.2019 nga “****” sh.p.k.

¹⁶ Shikoni aktekspertizën datë 24.6.2005, të ekspertit kontabël Q. K., të depozituar në QKB nga vetë shoqëria, shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

e shtatëdhjetë e nëntë) USD. Burimi i krijimit: aktiviteti nga puna e bashkëshortit në SHBA, në vitet 2007-2009, transferuar nëpërmjet bankës vlerën 19.976 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) USD; shtuar kursimet e bashkëshortit dhe të subjektit nga pagat dhe aktiviteti privat; si dhe interesat bankare. Fillimisht llogaria është hapur në vlerën 21.935 (njëzetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) USD.

38.1 Në lidhje me historikun e krijimit të kësaj depozite, nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se subjekti ka çelur në datën 18.2.2009, llogarinë rrjedhëse me nr. ***, në “Credins Bank”, datë në të cilën ka përfituar vlerën 19.976 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) USD, me përshkrimin “transfertë në mbërritje me /nga banka të tjera, urdhërues A. M.”. Subjekti ka deklaruar se kjo vlerë e ka burimin të të ardhurat nga puna e bashkëshortit në SHBA në periudhën 2007 – 2009 dhe ka paraqitur si dokument justifikues të transfertës¹⁷ kopje të mandatit të tërheqjes së vlerës 21.934 (njëzetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) USD nga depozita bankare në “Bank of America” në SHBA nga bashkëshorti i subjektit në datën 7.1.2009 (në emër të A., dhe Brunilda Malo).

Në datën 12.3.2009, vlera 19.976 (nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) USD transferohet nga subjekti në depozitën nr. ***, në “Credins Bank”.

38.2 Në datën 17.9.2010 vlera e mësipërme, shtuar edhe me interesa bankare (në një total prej 20.633 (njëzetmijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) USD), transferohet nga subjekti në depozitën nr. ***, në “Credins Bank”. Në të njëjtën datë, subjekti ka derdhur *cash* në këtë depozitë edhe vlerën 14.800 (katërmëdhjetë mijë e tetëqind) USD me përshkrimin “shtesë në depozitë”, të cilën në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 e ka deklaruar si pakësim të gjendjes *cash* nga kursimet familjare. Subjekti ka shpjeguar se kjo vlerë e ka burimin nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit nga puna dhe aktiviteti privat apo angazhime të tjera politike (përfshirë edhe disa kursime *cash* të sjella prej tij në vitin 2008 nga SHBA).

38.3 Konstatohet se subjekti nuk ka kryer veprime të tjera në këtë depozitë, e cila është shtuar me interesat bankare. Në datën 31.12.2016 gjendja e llogarisë ka qenë në vlerën 39.379 (tridhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) USD.

38.4 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duket se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk e justifikojnë me të ardhura nga burime të ligjshme krijimin e kësaj depozite në vitin 2009, si dhe shtesën e saj prej 14.800 (katërmëdhjetë mijë e tetëqind) USD të depozituar në datën 17.9.2010. Kjo pasuri është pasqyruar në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni.

39. Depozitë nr. ***, hapur në emër të subjektit në “Credins Bank”, me vlerë 22.284,32 (njëzetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) euro, transferuar nga “FiBank” – llogari në emër të bashkëshortit. **Burimi i krijimit:** kursime ndër vite nga aktiviteti privat, të ardhurat nga paga dhe aktiviteti politik i bashkëshortit, shtuar me interesat bankare. Zotërimi është 100 % nga bashkëshorti i subjektit.

39.1 Në lidhje me historikun e krijimit të kësaj depozite, “Fibank” konfirmon¹⁸ çeljen e një depozite në datën 14.8.2012 me qëllim blerjen e bonove të thesarit, në emër të subjektit dhe të bashkëshortit të saj dhe depozitimin e vlerës *cash* prej 22.000 (njëzetë e dy mijë) euro nga shtetasi A.M.

39.2 Në datën 18.8.2014 subjekti transferon vlerën 21.866 (njëzetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) euro nga “Fibank” në “Credins Bank”, në llogarinë nr. *** në emër të subjektit, me përshkrimin “transfertë personale për blerje prone”, dhe në datën 22.10.2014 transferon nga kjo depozitë vlerën 21.855 (njëzetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) euro në depozitën nr. ***. Kjo depozitë, shtuar me interesa bankare, në datën 31.12.2016, ka gjendje vlerën 22.284 (njëzetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) euro.

¹⁷ Sipas mandatpagesës lëshuar nga “Bank of America”, paraqitur nga subjekti në ILDKPKI.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2019, nga “Fibank”.

39.3 Në lidhje me përshkrimin e këtij transaksioni, subjekti deklaron¹⁹ se nuk ka blerë asnjë pasuri me vlerën e depozitës në “Fibank” të transferuar në “Credins Bank” dhe se, që nga momenti i transferimit të fondeve, kjo depozitë nuk është prekur dhe me të nuk janë kryer veprime, përveç shtimit të interesave bankare. Nga verifikimi rezultoi se subjekti nuk ka kryer transaksione apo veprime të tjera me vlerën e transferuar.

39.4 **Nga hetimi ka rezultuar** se subjekti nuk provon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të justifikuar krijimin e të ardhurave të ligjshme nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k.

40. Depozitë nr. ***, hapur në “Credins Bank”, në datën 25.1.2017, me vlerë 30.000 (tridhjetëmijë) euro. Burimi i krijimit: pakësimi i gjendjes *cash* në banesë, deklaruar në formularët e mëparshëm; kursime ndër vite nga aktiviteti privat; të ardhura nga paga dhe aktiviteti politik i bashkëshortit; dhe të ardhura nga paga e subjektit.

40.1 Me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave konfirmon se shtetasja Brunilda L. Malo ka raportime të transaksioneve bankare sipas tabelës në vijim:

Data	Banka	Nr. llogarie	Vlefte	Përshkrim
25.1.2017, ora 12:00	Union Bank	***	30.000 euro	Derdhje në depezitë, Bunilda Malo. Burimi: kontratë shitjesh + kursime.

40.2 “Credins Bank” konfirmon çeljen e depozitës nr. ***, datë 25.1.2017, dhe derdhjen e vlerës *cash* 30.000 (tridhjetëmijë) euro, nga subjekti me përshkrimin “burimi kontratë shitje dhe kursime”.

40.3 Subjekti deklaron²⁰ se vlera 30.000 (tridhjetëmijë) euro është vlera *cash* që ajo ka pasur në banesë pas vdekjes së bashkëshortit. Burimi i kësaj vlere janë kursimet për të gjithë periudhën e aktivitetit të bashkëshortit, kryesisht nga ortakëria në shoqërinë tregtare “****” sh.p.k., e shtuar me kursime të tjera, të cilat kanë si burim pagën e subjektit të rivlerësimit.

40.4 Në mbështetje të kësaj deklarate, subjekti sqaron se bashkëshorti i saj, vlerën *cash* 40.000 (dyzetë mijë) euro, me burim të ardhura nga aktiviteti, e ka deklaruar në deklaratën e interesave private të dorëzuar prej tij përpara fillimit të detyrës, në datën 26.11.2013 dhe se kjo vlerë është pakësuar vetëm me pushimet e viteve 2014 dhe 2015. Gjithashtu, subjekti deklaron se është thirrur nga ILDKPKI-ja për rideklarim në vitin 2015 dhe ka deklaruar se deri në momentin e deklaramit ka pasur gjendje *cash* në banesë vlerat 40.000 (dyzetë mijë) euro dhe 4.000.000 (katër milionë) lekë.

40.5 Konfirmohet deklarimi²¹ i subjektit në lidhje me gjendjen *cash* të subjektit të rivlerësimit në datën 31.12.2013, në vlerat 40.000 (dyzetë mijë) dhe 4.000.000 (katër milionë) lekë.

40.6 **Nga hetimi ka rezultuar** se subjekti nuk provon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të justifikuar krijimin e të ardhurave të ligjshme nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k.

41. Depozitë te Fondi i Investimeve në “Raiffeisen Bank” nr. ***, në emër të bashkëshortit në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Burimi i krijimit: shitja e banesës me sip. 80.6 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në ***, me kontratën nr. ***, datë 1.4.2015, në vlerën 1.860.000 (një milion e tetëqind gjashtëdhjetë mijë) lekë; dhe shitja e mobilieve dhe e elektroshtëpiakeve me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.4.2015, në vlerën 1.640.000 (një milion e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë, si pasuri në pjesë të barabarta në bashkëpronësi. Llogaria është hapur në datën 22.7.2015, në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë)

¹⁹ Pyetësoni nr. 4, përgjigje nr. 6/2 dhe pyetësoni nr. 2, përgjigje nr. 12

²⁰ Pyetësoni nr. 4, përgjigje nr. 7

²¹ Procesverbali datë 2.3.2015 (përgjigje nr. 12), sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.6.2019 nga ILDKPKI-ja.

lekë , shtuar me interesat, gjendja në datën 22.1.2017, në vlerën 3.891.240,68 (tre milionë e tetëqind e nëntëdhjetë një mijë e dyqind e dyzetë) lekë, me zotërim 50 % nga deklaruesja (në deklaratën “Vetting”).

41.1 “Raiffeisen Invest”²² konfirmon çeljen e Fondit të Investimit dhe blerjen e kuotave në datën 22.7.2015, në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë nga bashkëshorti i subjektit, si dhe mbylljen e kësaj llogarie në datën 17.5.2018. Subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për vitet 2016 dhe 2017, të ardhurat nga interesat e përfituara nga ky fond.

41.2 Nga hetimi rezulton se vlera 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë është transferuar nga llogaria e bashkëshortit të subjekti pranë “Raiffeisen Bank” te Fondi i Investimit, dhe burimi i krijimit të kësaj vlere janë:

a. Të ardhurat nga shitja e apartamentit në * , në vlerën 1.860.000** (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 1.4.2015,²³ transferuar nga blerësi i pasurisë në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, z. A. M., në “Raiffeisen Bank”, në datën 22.4.2015. Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues²⁴ për pagesën e tatimit në vlerën 25.488 (njëzetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

a.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 blerjen e këtij apartamenti me kontratën nr. ***, datë 23.2.2005²⁵, në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, në bashkëpronësi me bashkëshortin, por nuk shprehet mbi burimin e kësaj pasurie.

a.2 Mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar në pyetësorin nr. 4 se janë përdorur të ardhurat e siguruara deri në atë moment nga të dy bashkëshortët, duke përfshirë të ardhurat nga pagat, aktivitete të tjera të bashkëshortit, si dhe të ardhura nga fitimet e shoqërisë “****” sh.p.k.

Gjithashtu, subjekti shprehet se: *“Me sa kujtoj, përpara se të blihet kjo pasuri, është tërhequr gjithashtu dhe vlera 4.178.959 (katër milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë nga depozita bankare me nr. *** (deklaruar ne formularin e datës 16.3.2004). Nuk jam në gjendje të ndaj se cila nga këto të ardhura është përdorur ekzaktesisht për blerjen e shtëpisë së banimit dhe shpenzime të tjera që kemi bërë për disa punime në banesë dhe mobilimin, por di që kemi patur të ardhura të mjaftueshme dhe gjendje cash në banesë për të kryer këto shpenzime. Punime përmirësimi në apartament janë bërë nga punonjësit e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe me mjete e materiale ndërtimi të shoqërisë, e cila në atë periudhë ka pasur për ortak të vetëm dhe përfaqësues ligjor bashkëshortin, A.M.”*

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se: *“Të ardhurat totale të familjes sonë deri në dhjetor 2004, për të gjithë periudhën e punësimit deri në blerjen e kësaj pasurie kanë qenë në vlerën 25.132.133 (njëzetë e pesë milionë e njëqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tre) lekë. Pasuria shtëpi banimi është pasuria e parë e paluajtshme e blerë për familjen, përveç automjetit tip “Mitsubishi”, me targa ***, i blerë në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë në vitin 2003 me kontratën nr. ***, datë 19.12.2003, deklaruar në formularin e vitit 2004 dhe në deklaratën “Vetting”. Vlera monetare është jo vetëm e mjaftueshme për këto pasuri, por e gjitha e deklaruar dhe mbasi janë paguar detyrimet ligjore”.*

b. Të ardhura nga shitja e mobilieve dhe elektroshtëpiakeve, në vlerën 1.640.000 (një milion e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë, transferuar nga blerësi i pasurisë, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, z. A. M., në “Raiffeisen Bank”, në datën 30.3.2015.

b.1 Nisur nga vlera relativisht e lartë e përfituar nga shitja e pajisjeve shtëpiake subjekti është pyetur lidhur me shpenzimet që ka kryer për blerjen e tyre, të cilat më vonë i ka shitur në vlerën 1.640.000 (një milion e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë, të cilat nuk janë përfshirë asnjëherë si shpenzim në deklaratat periodike vjetore dhe as në analizën financiare të Komisionit. Po ashtu,

²² Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2019 nga “Raiffeisen Invest” sh.a.

²³ Referoju seksionit “gjetje të tjera” për më shumë informacion.

²⁴ Vërtetim nr. ***prot., datë 6.6.2019, nga ZVRPP-ja Kolonjë.

²⁵ Konfirmuar nga ZVRPP-ja Kolonjë me shkresën nr. *** datë 11.3.2019.

subjekti është pyetur nëse ka pasur detyrim për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfutur nisur edhe nga fakti se ajo nuk i ka deklaruar asnjëherë si shpenzime dhe tani po i deklaron si të ardhura.

b.2 Subjekti, në pyetësorin nr. 2²⁶, deklaron se vlera e pajisjeve dhe e mobilieve të shitura nuk është përcaktuar mbi bazën e faturave të blerjes së tyre, por me marrëveshje të lirë midis palëve. Subjekti shton se nuk i disponon faturat e blerjes së tyre, për shkak të kohës së gjatë të kaluar dhe se nuk është në gjendje të deklarojë saktësisht vlerën e shpenzimeve të kryera për pajisjet përpara momentit të shitjes, pasi mobilimi i apartamentit ka vazhduar për një kohë të gjatë.

b. 3 Në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e pajisjeve shtëpiake subjekti, në pyetësorin nr. 4,²⁷ deklaron se nuk ka paguar tatim mbi të ardhurat e realizuar nga shitja e mobilieve dhe elektroshtëpiakeve, të cilat kanë qenë të përdorura dhe janë shitur së bashku me apartamentin e banimit. Subjekti sqaron se nuk është në dijeni të ndonjë detyrimi ligjor për të paguar kundrejt shtetit, në rastet kur shiten sendet e luajtshme të përdorura të banesës dhe se shitja e mobilieve dhe sendeve të përdorura nuk është bërë me qëllim fitimin, pasi tatimi për këto pasuri është paguar bashkë me blerjen e tyre kur janë blerë në mënyrë fillestare (pagesa e TVSH-së), ndërsa në momentin e shitjes kjo vlerë ka qenë më e ulët se ajo e blerjes, pra, nuk kemi të bëjmë me një shitje me qëllim fitimin dhe as shitje që ka shtuar të ardhurat e familjes.

41.3 Subjekti nuk e ka bindur Komisionin lidhur me shitjen e pajisjeve të shtëpisë, si vlerë e veçantë nga ajo e shitjes së banesës. Duket se subjekti e ka shitur shtëpinë në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, por e ka ndarë vlerën e saj për të shmangur pagesën e tatimit mbi të ardhurat.

41.4 Të ardhurat e përfuturara nga shitja e **apartamentit në ***** blerë në vitin 2005, shërbyen si burim për krijimin e depozitës në Fondin e Investimeve, në “Raiffeisen Bank” në datën 22.7.2015. Komisioni hetoi edhe lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në *** në vitin 2005.

41.5 Pjesërisht, si burim për blerjen e apartamentit në *** kanë shërbyer të ardhurat në depozitën bankare nr. *** pranë ish-Bankës së Kursimeve. Për këtë subjekti ka paraqitur një vërtetim²⁸ nga “Raiffeisen Bank”, dega ***, i cili vërteton se znj. Brunilda Malo, në vitin 2002 ka çelur depozitën nr. *** me afat maturimi 3 muaj, me vlerë 5.408.181 (pesë milionë e katërqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë, e cila është mbyllur në vitin 2004. Subjekti e ka konfirmuar ekzistencën e kësaj depozite edhe përpara ILDKPKI-së në datën 2.3.2015²⁹.

41.6 Subjekti deklaron se burimi i krijimit të kësaj depozite janë: të ardhurat nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kolonjë; të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi; dhe të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë “****” sh.p.k., për vitin 2002 dhe deri në momentin e çeljes së kësaj depozite ajo dhe bashkëshorti nuk kanë blerë pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, kanë jetuar në banesën e prindërve të bashkëshortit dhe nuk kanë pasur shpenzime jetike pasi janë përballuar nga ata.

41.7 Nga hetimi u konstatua se subjekti e ka mbyllur këtë llogari në vitin 2004 dhe apartamentin në *** e ka blerë në shkurt të vitit 2005, por nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004.

41.8 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duket se vlera e depozitës së çelur nga subjekti në vitin 2002, në vlerën 5.408.181 (pesë milion e katërqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë, është e pajustificuar me burim të ligjshëm të të ardhurave.

²⁶ Pyetësori nr. 2, përgjigje nr. 4.

²⁷ Pyetësori nr. 4, përgjigja nr. 2.2.

²⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 14.6.2019.

²⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 27.6.2019 nga ILDKPKI-ja.

Nga hetimi nuk provohet se vlera e përfituar nga shitja e apartamentit në *** (përkatësisht vlera 1.640.000 (një milion e gjashtëqind e dyzetë mijë)) lekë, përfituar nga shitja e pajisjeve shtëpiake), e përdorur më pas si burim për krijimin e depozitës, duhet të merret në konsideratë si burim i ligjshëm.

42. Llogari rrjedhëse, nr. * në “Credins Bank”,** krijuar me të ardhurat nga paga e subjektit si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Gjendja në datën 25.1.2017 është në vlerën 271.906,8 (dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë.

42.1 Nga hetimi ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

43. Llogari rrjedhëse, nr. *, në “Raiffeisen Bank”,** krijuar me të ardhurat nga paga e bashkëshortit si Kryetar i Bashkisë Kolonjë deri në datën 25.9.2016. Gjendja në datën 24.1.2017 është në vlerën 113.288,33 (njëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

43.1 Nga hetimi ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

44. Gjendje cash në banesë në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, deklaruar në deklaratën “Vetting”, me burim: kursime nga paga dhe të ardhura të tjera ndër vite.

44.1 Komisioni ka përgatitur një tabelë lidhur me gjendjen *cash* në banesë në fund të çdo viti, për periudhën 2003 – 2016.

Viti	Përshkrimi në deklaratat periodike vjetore në ILDKPKI, Brunilda Malo	Gjendje progresive <i>cash-i</i> në fund të çdo viti	Shënime
2003	Nuk deklaron gjendje <i>cash</i>	0	
2004	Nuk deklaron gjendje <i>cash</i>	0	
2005	Gjendje <i>cash</i> 7.000 USD, 100 % bashkëshorti	723.310	7.000 USD gjendje <i>cash</i>
2006	Vlera monetare në banesë 5.000 USD (subjekti+ bashkëshorti)	1.191.670	Shtuar 5.000 USD në gjendjen <i>cash</i>
2007	Nuk deklaron <i>cash</i>	1.191.670	
2008	Kursime të paregjistruara në regjistra publikë 20.000 USD	3.010.870	Shtuar 20.000 USD në gjendjen <i>cash</i>
2009	Kursime <i>cash</i> në banesë (subjekti+ bashkëshorti) 10.000 euro.	4.382.570	Shtuar 10.000 euro në gjendjen <i>cash</i>
2010	Kursime nga të ardhurat e pagës së deklarueses, të ardhurat nga paga, angazhimet e tjera dhe aktivitetit privat i bashkëshortit 10.000 euro	3.716.282	Shtuar 10.000 euro në gjendjen <i>cash</i> ; zbritur nga gjendja <i>cash</i> 14.800 euro për shkak të derdhjes te depozita “Credins Bank” deklaruar në DPV-në e vitit 2010.
2011	Kursime nga të ardhurat e pagës së deklarueses, të ardhurat nga paga, angazhimet e tjera dhe aktivitetit privat i bashkëshortit 5.000 euro	4.407.782	Shtuar 5.000 euro në gjendjen <i>cash</i>
2012	Nuk deklaron gjendje <i>cash</i>	4.407.782	
2013	Nuk deklaron gjendje <i>cash</i>	9.60.400	40.000 euro kursime ndër vite nga pagat dhe aktiviteti privat i bashkëshortit + 4.000.000 lekë nga shpërblimi i dëmit nga shoqëria “****” sh.p.k., gjendje <i>cash</i> në banesë, deklaruar në ILDKPKI sipas procesverbalit, datë 2.3.2015, përgjigja nr. 12
2014	Kursime nga paga e deklarueses, gjendje <i>cash</i> në banesë 300.000 lekë	9.908.400	Shtuar 300.000 lekë në gjendjen <i>cash</i>
2015	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> me rreth 4.500.000 lekë për hapjen e llogarisë bankare nr. *** në “Raiffeisen Bank”, në monedhën GBP, në emër të vajzës A.M., me qëllim studimet në Londër 25.539,92 GBP	5.142.906	Zbritur 25.539,92 GBP nga gjendja <i>cash</i>

2016	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> në banesë dhe të të ardhurave nga pagat e deklarueses dhe bashkëshortit gjatë vitit 2016 me qëllim shtimin e depozitës së vajzës A. M. në llogarinë bankare nr. *** në "Raiffeisen Bank" 8 500 GBP	3.803.646	Zbritur 8.500 GBP nga gjendja <i>cash</i>
	Gjendje <i>cash</i> e deklaruar në deklaratën "Vetting"	1.000.000	
2017	Kursime <i>cash</i> në banesë nga të ardhurat vjetore 1.300.000	1.300.000	Gjendje <i>cash</i> 1.300.000 lekë, deklaruar në DPV-në e vitit 2017
2018	Gjendje <i>cash</i> në banesë më 31.12.2018, 1.926.000 lekë (750.000 lekë kursimet <i>cash</i> , viti 2017 + 1.176.000 lekë kursime <i>cash</i> , viti 2018); pakësuar me 550.000 lekë kursimet e vitit 2017 (derdhja 3.778 GBP në datën 29.5.2018)	1.926.000	

44.2 Nga përlllogaritjet e kryera në bazë të deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore, rezulton se gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë në datën 31.12.2016, ka qenë 3.803.646 (tre milionë e tetëqind e tre mijë e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë) lekë.

44.3 Subjekti, në deklaratën "Vetting", ka deklaruar se në datën 25.1.2017 ka çelur depozitën nr. *** në "Credins Bank", në vlerën 30.000 (tridhjetëmijë) euro, me burim: nga gjendja *cash* në banesë.

44.4 Nga përlllogaritjet e gjendjes së likuiditeteve *cash* në banesë, duket se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme: (a) të ketë likuiditete *cash* në banesë, në vlerën 1.000.000 lekë (një milion); si dhe (b) njëkohësisht të çelë depozitën nr.***, në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) euro.

45. Subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e ambientit "bar-kafe", me sip. 90 m², nr. pasurie *, z.k. ***, ndodhur në ***, me kontratë qiraje nr. ***, datë 21.4.2015, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.**

45.1 Subjekti ka paraqitur kontratën e qirasë³⁰ nr. ***, datë 21.4.2015, të qiradhënies së ambientit "bar-kafe", sipas së cilës kjo pasuri i jepet me qira për periudhën 1.11.2014 – 1.11.2019, në vlerën 5.000 (pesë mijë) lekë/muaj (kontratë me efekt prapaveprues) shtetasit I.H.

45.2 Palët deklarojnë se qiraja për periudhën 1.11.2014 – 30.4.2015 është likuiduar tërësisht nga qiramarrësi I.Xh.H. (e cila rezulton të jetë 30.000 (tridhjetë mijë) lekë³¹ deri në datën 30.4.2015). Qiraja për periudhën 1.5.2015 – 1.11.2015 (data e marrjes me qira e tokës bujqësore) është 30.000 (tridhjetë mijë) lekë³², pra, në total vlera e përfituar e qirasë për periudhën 1.11.2014 – 1.11.2015 është 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë. Gjithashtu, vlera totale e qirasë së përfituar nga kjo kontratë, nga data e nënshkrimit deri më 31.12.2016, rezulton të jetë 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë³³.

45.3 Kontrata, në nenin 5, parashikon detyrimin e qiradhënësit për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja.

- Provohet³⁴ derdhja e vlerës 100.000 (njëqind mijë) lekë nga shtetasi I.H., në datën 25.11.2015, nëpërmjet bankës.

- Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë informon se nuk rezultojnë pagesa të tatimit në burim mbi qiranë nga shtetasi A. M.

44.4 Subjekti, në pyetësin nr. 2³⁵, deklaron se nuk është në dijeni nëse tatimi mbi qiranë duhet të paguhej nga bashkëshorti i saj, apo nga qiramarrësi dhe se nuk disponon dokumentacion për të provuar pagesën.

³⁰Dokument nr. *** ref, dosja ILDKPKI.

³¹ 5.000 lekë*6 muaj.

³² 5.000 lekë*6 muaj

³³ 5.000 lekë*24 muaj

³⁴ Llogaria "Raiffeisen Bank" në emër të A. M.

³⁵ Pyetësi nr. 2, përgjigje nr. 3.

44.5 Nga hetimi nuk u administrua asnjë dokument ligjor provues i pagesës së tatimit në burim për qiranë. Këto të ardhura nuk u përfshinë në analizën financiare të Komisionit.

45. Të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit, si ortak i vetëm për vitet 2002 - 2004, më pas ortak me 33 % për vitet 2005 - 2006, dhe nga viti 2006 - 2012 ortak me 25 % në shoqërinë "****" sh.p.k., me seli në ***, në vlerën 24.161.748 (njëzetë e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzetë e tetë) lekë.

45.1 Në dokumentacionin e administruar nga ILDKLPKI-ja rezulton se subjekti ka paraqitur:

- i) vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë³⁶ mbi fitimin neto të shoqërisë për vitet 2002 - 2013, por nuk jepet informacion mbi dividendin e shpërndarë dhe/apo tatimin e paguar mbi dividendin nga kjo shoqëri;

- ii) aktekspertizë³⁷ mbi rritjen e kapitalit të kësaj shoqërie në datën 24.6.2005, sipas të cilit shoqëria ka zmadhuar kapitalin e saj me të gjitha fitimet e realizuara në periudhën tatimore 1997 - 2004;

- iii) dy vërtetime të lëshuar nga kjo shoqëri³⁸, e cila deklaron se ortakun A. M., ka përfitur fitim për periudhat tatimore 2005 dhe 2006.

45.2 Qendra Kombëtare e Biznesit informon³⁹ se shtetasi A. M., ka qenë ortak në shoqërinë "****" sh.p.k., me NIPT ***. Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të kësaj shoqërie rezulton se ky shtetas: ka qenë zotërues me 100% të kuotave të shoqërisë dhe administrator i saj në periudhën 7.5.2002 - 17.9.2004; zotërues me 33,33 % të kuotave të shoqërisë në periudhën 17.9.2004 - 29.9.2006; zotërues me 25 % të kuotave të shoqërisë në periudhën 29.9.2006 - 24.1.2013.

45.3 Sipas informacionit nga Qendra Kombëtare e Biznesit⁴⁰ kjo shoqëri ka kryer zmadhimin e kapitalit të saj, duke përdorur fitimet e realizuara gjatë viteve 1997-2004.

45.4 Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë⁴¹ informon Komisionin se nuk disponon të dhëna për dividend të derdhur nga shoqëria për vitet ushtrimore 2002-2012.

45.5 Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë ka informuar ILDKPKI-në⁴² se shoqëria "****" sh.p.k. ka deklaruar dividend vetëm për vitet 2008-2009 në vlerën totale 400.000 (katërqind mijë) lekë (pjesa takuese për ortakun A.M., llogaritet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë), dhe se nuk disponon të dhëna të tjera mbi dividendin e kësaj shoqërie. Nuk disponohen të dhëna as për pagesën e tatimit mbi dividendin.

45.6 Nga hetimi rezulton e paprovuar me dokumentacion ligjor përfitimi i të ardhurave nga aktiviteti i shoqërisë, në formën e dividendit për periudhën 2002 - 2004, si dhe për periudhën 2005 - 2012, për ortakun A.M. Këto të ardhura të deklaruara nga subjekti nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

46. Të ardhura të tjera nga:

a) shitja e 25% të kuotave të kapitalit në shoqërinë "****" sh.p.k. me kontratën nr. ***, datë 24.1.2013, sipas aktmarrëveshjes datë 7.1.2013, miratuar me vendimin nr. ***, datë 4.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, në vlerën 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë, deri 31.12.2016 janë ekzekutuar në vlerën 1.150.000 (një milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, nëpërmjet transfertës bankare.

b) shpërblymi i dëmit, shkaktuar nga cënimi i të drejtës së votës dhe mosmarrëveshjet për shpërndarjen e dividendit. Ky konflikt është zgjidhur me aktmarrëveshjen datë 7.1.2013;

³⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 6.2.2015, nga DRT-ja Korçë, paraqitur nga subjekti, dosja ILDKPKI ref. 4/13.

³⁷ Paraqitur nga subjekti, dosja ILDKPKI ref. 4/13.

³⁸ 2 vërtetime datë 17.9.2007, nga shoqëria "****" sh.p.k., paraqitur nga subjekti, dosja ILDKPKI ref. 4/13.

³⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 25.2.2019, nga QKB-ja.

⁴⁰ Shiko aktekspertizën datë 24.6.2005, të ekspertit kontabël Q.K., të depozituar në QKB nga vetë shoqëria, shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

⁴¹ Shkresa nr. *** prot., datë 27.5.2019, nga DRT-ja Korçë.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 17.7.2018, nga DRT-ja Korçë dhe e-mail datë 26.6.2018, nga DRT-ja Korçë (dokumenti 35).

deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.1.2013; dhe vendimin gjyqësor nr. ***/2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë.

46.1 Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti⁴³ dhe ai i administruar në dosje, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Korçë, në datën 20.11.2012, ortakët e tjerë të shoqërisë “***” sh.p.k., duke pretenduar se për periudhën 2006 – 2012 është përjashtuar nga vendimmarrja e shoqërisë dhe nuk ka përfituar të ardhura nga dividendi.

Në datën 7.1.2013 bashkëshorti i subjektit dhe ortakët e tjerë të shoqërisë, z. A. R., dhe z. Gj. Ç., kanë nënshkruar marrëveshjen midis palëve pranë Qendrës së Ndërmjetësimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sipas të cilës këta të fundit deklarojnë se i detyrohen ortakut A. M., vlerën 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë, e cila përfshin:

- vlerën e pjesës së kapitalit prej 25 % të zotëruar te shoqëria “***” sh.p.k., në vlerën 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë, e cila do të shlyhet me këste brenda datës 31.3.2017, nëpërmjet pagesave në llogarinë bankare të ortakut A. M., ose me para në dorë, të vërtetuara me një dokument të firmosur nga palët;
- vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë e cila përfaqëson dëmin e shkaktuar nga mospagimi në kohë i dividendit nga aktiviteti i shoqërisë. Kjo vlerë është shlyer jashtë zyrës së ndërmjetësimit.

Në datën 24.1.2013, palët kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. ***, ku pranojnë të gjitha kushtet e parashikuara në marrëveshjen e sipërcituar.

Në datën 4.2.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. ***, miraton pajtimin e arritur midis palëve dhe likuidimin e kuotave të kapitalit kundrejt ortakut A.M.

46.2 Subjekti është pyetur në lidhje me mënyrën dhe datën e kryerjes së pagesës në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë, për shkak të dëmit të shkaktuar, e cila në pyetësonin nr. 2⁴⁴, ka deklaruar se kjo pagesë është kryer në *cash*, përpara paraqitjes së palëve në zyrën e ndërmjetësimit, në datën 7.1.2013, pa specifikuar ndonjë datë (pagesa *cash* parashikohej edhe në marrvjeshe).

Subjekti e ka konfirmuar në datën 2.3.2015⁴⁵ edhe përpara ILDKPKI-së, marrjen e kësaj vlere si dhe që ajo është mbajtur *cash* në banesë⁴⁶ deri në datën 31.12.2013.

46.3 **Nga hetimi u rezultoi:** (1) e pa provuar me ndonjë dokumentacion marrja vlerës 4.000.000 (katër milionë) lekë nga bashkëshorti i subjektit (deklaratë/dëshmi); (2) provohet përfitimi i vlerës 2.648.500 (dy milionë e gjashtëqind e dyzetë e tetë mijë e pesëqind) lekë nga shitja e 25 % kuotave, përfituar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit (në vlerën 1.150.000 (një milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në datën 31.12.2016 dhe në vlerën 1.498.500 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë në periudhën 2017-2018); (3) nuk provohet me dokumentacion ligjor pagimi i tatimit mbi: të ardhurat e përfituara nga shitja e kuotës dhe të ardhurat e përfituara nga dëmi i shkaktuar.

46.4 Këto të ardhura u përfshinë në analizën financiare të Komisionit, por ju kërkua subjektit të shpjegojë bindshëm lidhur me paqartësitë e evidentuara nga hetimi.

47. Të ardhura nga puna e kryer nga bashkëshorti në SHBA në vitet 2007-2009, në shtetin e Floridas, me statusin e rezidentit, Instrument Transformer (Genesis Consolidated Service INC) transferuar në “Credins Bank” në llogarinë e subjektit të rivlerësimit.

47.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 subjekti ka deklaruar të ardhura në vlerën 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) USD nga puna në “Instrument Transformer General Electric” Florida, SHBA. Subjekti, në pyetësonin nr. 4⁴⁷, sqaron se sipas deklarimeve të bashkëshortit të

⁴³ Referojuni dosjes së ILDKPKI, ref. 4/13.

⁴⁴ Pyetësoni nr. 2, përgjigje nr. 6.

⁴⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 27.6.2019 nga ILDKPKI-ja, përgjigje nr. 9.

⁴⁶ Përgjigje nr. 12, procesverbali ILDKPKI.

⁴⁷ Përgjigje nr. 8.

saj, ka pasur të ardhura në vlerën 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) USD nga punësimi në SHBA për vitet 2007-2008.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti ka deklaruar çeljen e një depozite në “Credins Bank” (trajtuar te likuiditetet), me burim të ardhura të përfituara nga puna në SHBA e bashkëshortit, dhe të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, në vlerën 20.000 (njëzetmijë) USD.

47.2 Mbi këtë marrëdhënie punësimi subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se bashkëshorti ka jetuar dhe punuar në vitet 2007-2009, në Florida, SHBA, me statusin e rezidentit (i pajisur me *Green Card*) duke punuar në shoqërinë “****”, në Florida. Të gjitha të ardhurat e përfituara i ka marrë nëpërmjet sistemit bankar (llogari bankare në Bank of America), dhe më tej në muajin mars 2009 i ka transferuar po nëpërmjet sistemit bankar në Shqipëri, në llogarinë bankare në “Credins Bank”⁴⁸ në emër të subjektit vlerën prej 19.976 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) USD.

47.3 Subjekti, në lidhje me burimin e këtyre të ardhurave, ka paraqitur⁴⁹ deklaratat tatimore të dorëzuara pranë autoriteteve tatimore në SHBA, nga ku rezulton se vlera totale e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit në vitet 2007-2008 është 14.588 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) USD, përkatësisht vlera 4.625 (katër mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë) USD në vitin 2007 dhe vlera 9.963 (nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) USD në vitin 2008.

47.4 Subjekti, pasi u pyet nga Komisioni mbi të ardhurat totale të bashkëshortit nga punësimi në SHBA dhe mbi kursimet nga këto të ardhura, ka paraqitur⁵⁰ kopje (jo në formën e kërkuar nga ligji) të formularit të rimbursimit të taksave për vitet financiare 2007 dhe 2008, me qëllim dokumentimin e të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti dhe deklaroi se gjatë periudhës 2007 – 2009 ka realizuar të ardhura nga punësimi pranë kompanisë “****”⁵¹ (nuk dokumentohen të ardhura nga punësimi për vitin 2009).

47.5 Subjektit i është kërkuar të paraqesë kontratën e punësimit të bashkëshortit në SHBA, por subjekti deklaroi⁵² se nuk disponon kontratë punësimi të bashkëshortit dhe se e ka objektivisht të pamundur ta sigurojë atë.

47.6 Nga hetimi rezultoi se vlera prej 19.976 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) USD transferuar në llogarinë e subjektit pranë “Credins Bank” në vitin 2009 është më madhe se vlera e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti dhe të dokumentuara në deklaratat tatimore (14.588 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) USD), në masën prej 7.346 (shtatë mijë e treqind e dyzetë e gjashtë) USD.

PERSONAT E LIDHUR

48. Subjekti i rivlerësimit ka dy vajza, A., dhe A. M., të cilat aktualisht studiojnë në Londër, për të cilat në deklaratat periodike vjetore dhe në pyetësin nr. 1 ka deklaruar shpenzime arsimimi dhe jetese, si më poshtë:

- **A.M.**, në periudhën janar 2016 – korrik 2016 ka studiuar në *** International College, me tarifën 13.790 (tremëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) GBP (ose 2.336.144 ‘dy milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzetë e katër’ lekë). Në shtator 2016 ka filluar studimet në *** University në Londër, Mbretëria e Bashkuar me tarifën vjetore 9.750 (nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) GBP (ose 1.536.210 ‘një milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dhjetë’ lekë) për vitin 2016-2017 dhe tarifën vjetore 12.500 (dymbëdhjetë mijë

⁴⁸ Konfirmohet transferimi i vlerën 19 976,8 USD në datën 18.2.2009, në llogarinë bankare nr*** të subjektit pranë “Credins Bank”.

⁴⁹ Referojuni dokumentacionit në dosjen e ILDKPKI-së, ref. 4/13.

⁵⁰ Pyetësin nr. 4, përgjigja nr. 8.

⁵¹ Subjekti sqaron në përgjigjen nr. 7, pyetësin nr. 2, se në deklaratën “Vetting” ka deklaruar gabimisht emrin e punëdhënësit të bashkëshortit “****” (që në fakt është përshkrimi i punës) në vend të “**** Corporation”. Gjithashtu, subjekti sqaron se kompania “****” është kompania që ka testuar dhe marrë në punë bashkëshortin e saj, mbi bazën e bashkëpunimit midis dy kompanive.

⁵² Pyetësin nr. 2, përgjigja nr. 7.

e pesëqind) gbp (ose 1.874.375 ‘një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë’ lekë) për vitin 2017-2018.

- **A.M.**, në periudhën 2007 – 2018 ka studiuar në Korçë dhe në muajin shtator 2018 ka filluar studimet në *** International College me tarifën vjetore 17.239 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) GBP (ose 2.381.391 ‘dy milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e një’ lekë).

48.1 Llogari kursimi në emër të A. M., në monedhën GBP, me nr. llogarie ***, me vlerën 13.000 (trembëdhjetë mijë) GBP hapur në “Bank Lloyds Londër”, Mbretëria e Bashkuar.

Gjatë hetimit administrativ subjekti ka paraqitur ekstraktin e kësaj llogarie, si dhe dokumentacionin ligjor provues për burimin e krijimit të saj. Të dhënat e kësaj llogarie janë përfshirë në analizën financiare.

48.2 Llogari rrjedhëse në emër të A. M., në monedhën GBP, me nr. llogarie ***, në vlerën 242,15 (dyqind e dyzetë e dy) GBP, në datën 27.10.2016, në “Bank Lloyds Londër”, Mbretëria e Bashkuar.

Gjatë hetimit administrativ subjekti ka paraqitur kopje në gjuhën angleze të lëvizjeve të kësaj llogarie bankare, jo në formën e kërkuar nga ligji. Të dhënat e kësaj llogarie janë përfshirë në analizën financiare.

48.3 Llogari kursimi në emër të A. M., në monedhën GBP me nr. llogarie *** hapur në “Raiffeisen Bank” në datën 11.11.2015, e cila aktualisht është mbyllur dhe vlera është transferuar në dy llogaritë e trajtuara më sipër.

Burimi i krijimit: kursimet ndër vite të prindërve A.M dhe Brunilda Malo, kryesisht të ardhura nga biznesi i A.M.

Në deklarinimin e interesave private periodike vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë dhe hapjen e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” në monedhën GBP me qëllim studimet e vajzës A.M., në Londër, llogari në emër të A.M.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 çeljen e llogarisë nr. *** në “Raiffeisen Bank” me qëllim studimet e vajzës A. M., në Londër, dhe gjendjen e kësaj llogarie në vlerën 25.539,92 (njëzetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) GBP; burimi i kësaj llogarie pakësim i gjendjes *cash* në banesë në vlerën rreth 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë.

Në këtë llogari janë kryer transaksionet e mëposhtme:

a) Në datën 11.11.2015, vajza e subjektit, A. M., ka kryer derdhjen e vlerës 3.200.000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, me përshkrimin “A. M., derdhje në llogari. Burimi: dhurim nga shitja e biznesit të babait”.

b) Në datën 25.11.2015 bashkëshorti i subjektit ka derdhur vlerën prej 9.330 (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) GBP me përshkrimin “A. M., derdhur GBP në llogari të ardhura nga biznesi”.

c) Në datën 18.7.2016 babai i bashkëshortit të subjektit, z. M. M., ka derdhur vlerën 2.000 (dymijë) GBP në llogarinë e A. M., në “Raiffeisen Bank”. Subjekti e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, si dhuratë në vlerën prej 2.000 (dymijë) GBP nga z. M. M., për mbesën A. M. Subjekti, mbi burimin e kësaj vlere, deklaroi⁵³ se janë të ardhura nga dërgesat dhe dhuratat e bëra nga vëllezërit e bashkëshortit të saj, A., dhe A. M., të cilët janë në emigracion në Londër, që prej vitit 1997.

⁵³ Pyetësor nr. 2, përgjigje nr. 14.

ç) Në datën 18.7.2016 bashkëshorti i subjektit ka derdhur vlerën prej 8.500 (tetë mijë e pesëqind) GBP në këtë llogari. Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 se burimi i kësaj vlere janë kursimet e saj dhe të bashkëshortit ndër vite.

d) Në datën 15.1.2016 është kryer pagesa prej 8.438,17 (tetë mijë katërqind e tridhjetë e tetë) GBP për *** International College, me përshkrimin “pagesë pjesore për shkollim”. Ky transaksion është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016.

dh) Në datën 15.1.2016 është kryer transfertat prej 6.500 (gjashtë mijë e pesëqind) GBP kundrejt shtetasit O. Sh. C., i datëlindjes 16.1.1991 me përshkrimin “dhënie hua”. Subjekti ka sqaruar në përgjigjen nr. 16, të pyetësorit nr. 2, arsyet e transferimit të kësaj vlere te ky shtetas (trajtuar më poshtë).

Kjo llogari rezulton e mbyllur në datën 16.1.2017.

48.4 Subjekti nuk ka deklaruar shpenzime akomodimi dhe jetese të vajzës gjatë studimeve në vitin 2016 në Londër dhe burimin e financimit të tyre.

49. Mbi transfertat bankare të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

49.1 Me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2017,⁵⁴ Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, konfirmon se ka raportime të transaksioneve bankare për shtetasen Brunilda L. Malo, sipas tabelës në vijim:

Data	Banka	Nr. llogarie	Vlefte	Përshkrim
17.09.2010, Ora 12:00	Credins Bank	***	14.800 USD	Shtesë në depozitë
29.03.2011, Ora 12:12	BKT	***	37.000 Euro	Brunilda Malo derdhur në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., paguar për blerje apartamenti për L. O. Burimi i të ardhurave: nga kursimet.

49.2 Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 ka deklaruar çeljen e depozitës bankare nr. ***, në “Credins Bank”, në datën 17.9.2010, me burim mbylljen e depozitës nr. *** pranë të njëjtës bankë dhe shtimin e disa kursimeve të tjera të deklaruara në deklaratat periodike vjetore të mëparshme (50 % në pronësi).

49.3 Subjekti në datën 17.9.2010, ka derdhur vlerën 14.800 (katërmëdhjetë mijë e tetëqind) euro, në “Credins Bank” dhe e pyetur në lidhje me burimin e krijimit të kësaj vlere, në pyetësorin nr. 2⁵⁵, deklaroi se kjo vlerë e ka burimin te kursimet *cash* në banesë, me burim të ardhurat e deklaruara në deklaratat periodike vjetore përpara vitit 2010 dhe një pjesë e vogël e sjellë nga bashkëshorti kur është kthyer nga SHBA në vitin 2008, përveç kursimeve të transferuara nga “Bank of America”, në vlerën 19.976 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) USD, në datën 17.2.2009.

49.4 Subjekti në datën 29.3.2011 ka derdhur vlerën 37.000 (tridhjetë e shtatë mijë) euro në Bankën Kombëtare Tregtare. Për derdhjen e kësaj vlere, subjekti deklaroi⁵⁶ se është kryer në emër dhe për llogari të prindërve të saj, L., dhe S. O., me qëllim blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 56 m² në adresën: Rr. “***”, z.k. ***, nr. pasurie ***, Tiranë. Subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacion⁵⁷, sipas të cilit babai i subjektit e ka blerë në vlerën 43.700 (dyzetë e tre mijë e shtatëqind) euro, në datën 19.1.2012 këtë pasuri dhe e ka regjistruar në emrin e tij, në organet kompetente.

49.5 Arsyeja e derdhjes së kësaj vlere nga subjekti ka qenë fakti se shoqëria ka pasur llogari bankare te “BKT”-ja, e cila nuk ka pasur degë të saj në qytetin e *** (vendbanim i prindërve të subjektit).

⁵⁴ Sipas dokumentit me nr. reference 38, dosja ILDKPKI.

⁵⁵ Pyetësori nr. 2, përgjigje nr. 10.

⁵⁶ Pyetësori nr. 2, përgjigje nr. 11.

⁵⁷ Kontratë porosie nr. *** datë 8.6.2010, midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasit L. O.; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 12.12.2011, midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasit L. O.; vërtetim hipotekor dhe certifikatë pronësie nga ZVRPP-ja Tiranë.

49.6 Subjekti deklaron se e ka marrë *cash* këtë vlerë nga babai i saj dhe e ka derdhur për llogari të tij në “BKT”, duke moshtuar dhe as pakësuar pasurinë e familjes së subjektit dhe nuk është përdorur për interesat e tyre, prandaj marrëdhënia e krijuar në këtë rast, nuk përfaqëson marrëdhënie interesi pasuror, biznesi, dhurimi, huadhënie dhe huamarrje, por thjesht një ndihmë në kuadrin e marrëdhënieve të ngushta familjare.

49.7 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 subjekti nuk e ka deklaruar veprimin e kryer për derdhjen e vlerës 37.000 (tridhjetë e shatë mijë) euro, me qëllim blerjen e apartamentit për babanë e saj.

49.8 Referuar analizës financiare të prindërve të subjekti, duket se ata nuk kanë pasur mundësi të kursejnë vlerën 37.000 (tridhjetë e shatë mijë) euro, me të ardhurat nga punësimi dhe pensionet e tyre.

ANALIZA FINANCIARE E PËRGATITUR NGA KOMISIONI

50. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, ku janë përfshirë veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur të trajtuara më lart në këtë vendim, ka rezultuar:

a) për periudhën deri para fillimit të deklarimit (viti 2003), duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë një situatë financiare negative në vlerën 1.200.525 (një milion e dyqind mijë e pesëqind e njëzetë e pesë) lekë;

b) për periudhën 2003 - 2016, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk justifikojnë me burime të ligjshme pasuritë, gjendjen e likuiditeteve në fund të çdo viti, si dhe shpenzimet e kryera, në vlerën - 19.514.051 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e katërbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e një) lekë;

c) për periudhën 2017 - 2018, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk justifikojnë me burime të ligjshme pasuritë, gjendjen e likuiditeteve në fund të çdo viti, si dhe shpenzimet e kryera, në vlerën - 409.119 (katërqind e nëntë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, në vitin 2017;

d) nga analiza financiare, duket se aftësia e kursimit të prindërve të subjektit për periudhën 1998 - 2005 ka qenë në vlerën 1.537.063 (një milion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë, si dhe të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit të siguruara nga punësimi për periudhën 1998 - 2005, kanë qenë të mjaftueshme për krijimin e depozitave të kursimit në vitin 2006, në vlerën totale prej 1.173.899 (një milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, në “Raiffeisen Bank”;

dh) nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duket se prindërit e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 - 1997 nuk kanë pasur mundësi për krijimin e depozitës në vlerën prej 1.600.518 (një milion e gjashtëqind mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, në “Raiffeisen Bank”.

50.1 Në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga veprimtaria tregtare e bashkëshortit të subjektit, pasi nuk kemi disponuar dokumente ligjore që të provojnë ndarjen e dividendit nga shoqëria dhe pagimin e tatimit përkatës për dividendin.

50.2 Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor: (a) pagimin e tatimit mbi të ardhurat që ka përfituar nga shitja e kuotës në vitin 2013; (b) marrjen e dëmshpërblimit nga shoqëria në vitin 2013 në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë; dhe (c) pagimin e tatimit për të ardhurën e përfituar, por këto të ardhura janë marrë në konsideratë në analizën financiare të Komisionit dhe priten shpjegime nga subjekti.

Analiza financiare 2017 -2018

Përshkrimi	2017	2018
PASURI	-1 109 639	-2 094 469
Diferencë Likuiditeti (Lik. të vitit Aktual - Lik. të vitit Paraardhës)	-1 109 639	-2 094 469
LIKUIDITETE (FUND VITI Dok.)	0	0
DETYRIME	0	0
PASURINETO (PASURI - DETYRIME)	-1 109 639	-2 094 469
TE ARDHURA të dokumentuara	2 416 367	6 077 431
Të ardhura të dokumentuara nga paga si gjykatëse SR	1 375 995	1 385 103
Të ardhura nga marrëveshja me ortaket e "xxxx" shpk	499 500	999 000
Interesa vjetore të depozitës në USD me nr. xxxxxx CREDINS - Brunilda Malo	33 442	36 366
Interesa vjetore të depozitës në Euro me nr. xxxxxx pranë Bankës Credins	7 550	11 719
Interesa të depozitës tek Fondi i Investimeve pranë Raiffeisen Bank	0	490 276
Të ardhura nga pensioni ISSH për vajzat A. M. dhe A. M.	119 880	119 880
Të ardhura nga shitja e automjetit MITSUBISHI viti 2017	380 000	0
Dhuratë për A. M., nga gjyshja S. O.	0	1 923 880
Të ardhura nga puna ne shoqerine "xxxx", UK A. M. - viti 2018	0	1 111 208
SHPENZIME	3 935 125	7 540 291
Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	470 184	411 411
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit sipas sistemit TIMS	263 228	332 864
Shpenzime arsimimi Shkolla jo publike "xxxx" - A.M. (e bija SR)	100 000	50 000
Shpenzime blerje me karte jashte vendit Brunilda Malo - Credins Bank	329 087	567 958
Shpenzime arsimimi A. M. në University of xxx (Londer)	1 874 375	0
Shpenzime qiraje A. M. në Londër 12.06.2018-31.12.2018	0	618 390
Shpenzime jetese A. M. në Londër - llog.bankare nr.xxxx - xxxx Bank	898 251	2 703 789
Shpenzime arsimimi A. M. në xxxxx College (Londer)	0	2 381 391
Shpenzime jetese A. M. në Londër (tetor - dhjetor 2018)	0	474 488
Analiza dokumentuar	-409 119	631 609

Analiza financiare 2003-2016

Subjekti BRUNILDA MALO (ORHAND)	Para vitit 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	5 408 181	-629 222	-4 178 959	3 002 175	2 655 355	2 875 983	2 040 984	3 309 502	1 113 881	775 060	3 043 700	5 611 805	2 160 823	3 434 262	-1 087 532	27 535 998
Automjet MITSUBISHI targa xxxc në pronësi të SR		600 000														600 000
Apartament banimi s.jp. 80.6 m2 në Ersekë (blerë në 2005 dhe shitur në 2015)				1 700 000												1 700 000
Automjet VOLKSWAGEN Polo targa xxxc në pronësi të bashk. të SR					1 845 000											1 845 000
Apartament banimi s.jp. 73.78 m2 xxxx Korçë						4 000 000										4 000 000
Lokal me s.jp. 90 m2 xxxx Ersekë													1 700 000			1 700 000
																0
Diferencë Likuiditeti (Lik. të vitit Aktual - Lik. të vitit Parardhës)	5 408 181	-1 229 222	-4 178 959	1 302 175	810 355	-1 124 017	2 040 984	3 309 502	1 113 881	775 060	3 043 700	5 611 805	460 823	3 434 262	-3 087 532	17 690 998
LIKUIDITETE (FUND VII DOK.)	5 408 181	4 178 959	0	1 302 175	2 112 531	988 514	3 029 498	6 338 999	7 452 881	8 227 941	11 271 640	16 883 446	17 344 269	20 778 530	17 690 998	
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURINETO (PASURI - DETYRIME)	5 408 181	-629 222	-4 178 959	3 002 175	2 655 355	2 875 983	2 040 984	3 309 502	1 113 881	775 060	3 043 700	5 611 805	2 160 823	3 434 262	-3 087 532	27 535 998
TE ARDHURA E dokumentuara	4 207 656	1 210 196	1 780 053	2 123 096	1 917 953	2 094 419	2 476 000	1 805 636	1 802 982	1 706 759	1 606 405	5 948 318	3 001 321	4 393 292	2 029 620	37 732 597
Të ardhura të dokumentuara nga paga si gjykatëse SR	2 374 139	694 015	1 135 524	1 048 705	1 193 287	1 208 467	1 151 322	1 191 704	1 178 236	1 173 194	1 207 736	1 229 592	1 323 567	1 303 309	1 346 184	18 758 981
Të ardhura nga lejet e lindjeve SR (vitet 1996, 1997 dhe 2000)	232 650															232 650
Të ardhura të dokumentuara nga mësimdhënia në Universitetin xxxx Korçë SR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	229 500	0	0	0	229 500
Të ardhura të dokumentuara nga paga Këshilli i Rrethit Ersekë	186 344	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	186 344
Pagesë papunësie nga DRSSH Kolonjë janar - korrik 1997	14 404															14 404
Të ardhura të dokumentuara nga paga Partia Socialiste Ersekë bashkëshorti SR	1 210 221	357 360	357 360	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 924 941
Të ardhura si Kryetar i Këshillit Bashkiak Ersekë	70 929	43 954	52 650	66 600	52 650	75 600	75 600	79 920	79 920	39 960	0	0	0	0	0	637 783
Të ardhura nga shpërbimet si Këshilltar i Këshillit të Qarkut Korçë 2001 - 2016 bashkëshorti SR	118 968	114 867	118 800	117 810	111 499	111 134	19 764	105 300	126 360	31 590	0	0	40 698	10 175	0	1 026 965
Të ardhura si Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Korçë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	124 612	741 648	270 134	0	1 136 394
Të ardhura si Kryetar i Bashkisë Kolonjë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	322 936	545 095	868 031
Të ardhura nga paga e bashkëshortit SR inxhinier pranë "xxxx" shpk	0	0	115 719	139 981	189 408	315 204	323 080	378 240	378 240	378 240	318 525	0	0	0	0	2 536 637
Të ardhura nga dërnshpërblimi për automjetin e demtuar, nga shoqëria "xxxx"				750 000												750 000
Të ardhura nga shitja e automjetit NISSAN në vitin 2006					371 109											
Të ardhura nga puna e bashkëshortit SR në SHBA 2007-2009						384 014	906 234									1 290 248
Të ardhura nga shitja e kuotave të shoqërisë "xxxx" shpk												150 000	500 000	500 000		1 150 000
Të ardhura nga dërnshpërblimi nga ortakët e shoqërisë "xxxx" shpk												4 000 000				4 000 000
Interesa nga depozita në USD tek CREDINS - Brunilda Malo							50 472	40 226								90 697
Interesa vjetore të depozitës në USD tek CREDINS - Brunilda Malo									83 775	80 144		74 909	77 146	57 859	67 837	441 670
Interesa nga bonot e thesarit në llogarinë pranë FIBANK												139 705				139 705
Interesa vjetore të depozitës në Euro pranë Bankës Credins														38 356	20 369	58 725
Interesa të depozitës tek Fondi i Investimeve pranë Raiffeisen Bank																0
Fitim nga shitja e sendeve të luajtshme së bashku me apartamentin në Ersekë														0		0
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Ersekë në vitin 2015														1 860 000		1 860 000
Dhuratë nga vëllai i bashkëshortit SR A.M.													358 960			358 960
Të ardhura nga pensioni ISSH për vajzat A. M. dhe A. M.															39 960	39 960
Të ardhura nga shitja e automjetit MITSUBISHI viti 2017																0
Dhuratë për vajzën A. M. nga gjyshja S. O.																0
Të ardhura nga puna në shoqërinë "xxxx", UK A. M., - viti 2018																0
																0
Numri i personave		4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	3	0
SHPENZIME	0	375 856	1 261 135	1 002 770	906 073	1 620 532	935 351	1 496 843	1 239 156	1 291 817	1 487 500	1 242 165	1 924 758	3 473 225	6 863 664	25 120 845
Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	0	375 856	375 856	438 228	438 228	546 480	546 480	546 480	546 480	546 480	558 192	564 096	879 992	897 104	646 503	7 906 455
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit sipas sistemit TIMS		0	885 279	564 542	467 845	804 052	118 871	680 363	422 676	475 337	794 308	476 013	698 168	1 104 410	307 122	7 798 986
Shpenzime për tatimin mbi të ardhurat nga shitja e apartamentit në Ersekë, në datën 17.04.2015														25 488		25 488
Shpenzime arsimimi, Shkolla jo publike "xxxx" - A. M. (e bija SR)						135 000	135 000	135 000	135 000	135 000						675 000
Shpenzime arsimimi Shkolla jo publike "xxxx" - A. M. (e bija SR)						135 000	135 000	135 000	135 000	135 000	135 000	135 000	135 000			1 080 000
Shpenzime arsimimi Shkolla jo publike "xxxx" - A. M. (e bija SR)														50 000	100 000	150 000
Shpenzime blerje me karte jashtë vendit Brunilda Malo - Credins Bank												67 056	48 774	247 415	170 783	534 028
Shpenzime karta Visa Classic Brunilda Malo - Credins Bank													162 824	32 155		194 979
Marje me qira e tokës bujqësore me s.jp. 2.670 m2 në Ersekë														110 000		110 000
Shpenzime arsimimi A. M. në xxxx College (Londer)														1 006 653	1 329 491	2 336 144
Shpenzime arsimimi A. M. në University of xxx (Londer)															1 536 210	1 536 210
Shpenzime qiraje A. M. në Londër 12.06.2018-31.12.2018																0
Shpenzime jetese A. M. në Londër - llog.bankare nr.xxxx - xxxx Bank															2 773 554	2 773 554
Shpenzime arsimimi A. M. në xxxx College (Londer)																0
Shpenzime jetese A. M. në Londër (tetor - dhjetor 2018)																0
																0
Analiza dokumentuar	-1 200 525	1 463 562	4 697 877	-1 881 849	-1 643 475	-2 402 096	-500 335	-3 000 709	-550 056	-360 118	-2 924 795	-905 653	-1 084 260	-2 514 194	-1 746 512	

51. Në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, Komisioni arriti në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, pasi sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, e subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.

Pasuri të ligjshme për qëllim të ligjit do të konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

Nëse subjekti përpiqet të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

52. Trupi gjykues i Komisionit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, vlerësoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga ajo në vijim të rezultateve të hetimit dhe ato në seancën dëgjimore publike.

53. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor se shoqëria “****” sh.p.k. ka shpërndarë dividend ndër vite. Nuk u disponua asnjë vendim i shoqërisë për shpërndarje dividendi. Nuk u provua në asnjë formë se ky dividend është marrë nga bashkëshorti i subjektit dhe për të të jetë paguar tatimi mbi dividendin. Subjekti arriti të provojë me dokumentacion vetëm fitimin neto të shoqërisë.

54. Nga ana tjetër referuar dokumentacionit të administruar në dosje ka rezultuar se shoqëria “****” sh.p.k. ka kryer zmadhim të kapitalit në vitin 2006, duke përdorur fitimin neto të saj të pashpërndarë ndër vite (për vitet 2002-2006).

55. Po ashtu, ka rezultuar se në vitin 2013 konflikti i lindur mes palëve, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me cilësinë e ortakut në shoqërinë “****” sh.p.k. dhe dy ortakëve të tjerë, ka pasur si objekt pretendimet⁵⁸ e bashkëshortit të subjektit z. A.M., me cilësinë e paditësit për “detyrimin e të paditurit shoqëria tregtare “****” sh.p.k. të kryejë pagesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë (dividend) për të gjithë periudhën e papaguar deri në ditën e ekzekutimit të vendimit”. Paditësi vetë ka pretenduar se nga momenti kur është caktuar administrator shtetasi A.R, shoqëria tregtare i ka shkëputur marrëdhëniet me ortakun A.M., duke e përjashtuar *de facto* nga çdo lloj aktiviteti apo dhe shpërblimi nga shpërndarja e fitimit për gjithë vitet nga 2006 e në vazhdim.

56. Ky konflikt është zgjidhur me marrëveshje nga e cila rezulton se ortaku A.M., shet kuotën e tij ortakëve të tjerë, duke realizuar përmes një kontrate shitjeje në vlerën 6.000. 000 (gjashtë milionë) lekë. Gjithashtu, me marrëveshje palët kanë rënë dakord që të njihet vlera 4.000.000 (katër milionë) lekë e dëmit të shkaktuar, e cila i është likuiduar palës cash.

57. Lidhur me përfitim e dëmshpërblimit subjekti ka sqaruar se bashkëshorti e ka marr atë *cash* nga ortakët e tjerë, por nuk dha asnjë informacion/shpjegim mbi detyrimin ase jo për pagimin e tatimit mbi këtë vlerë të përfituar.

58. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”- nuk ka përcaktim të qartë për taksimin e të ardhurave nga “shpërblimi i dëmit” por:

- a. neni 8, paragrafi/g, konsideron të ardhura personale të tatueshme: “g) Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”;

⁵⁸ Vendimi nr. ****, datë 4.2.2013.

b. ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 8/1, paragrafi/9, përjashton nga tatimi: “9. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore”.

59. Në vijim rezulton se përfitimi i dëmshpërblimit është bërë me marrëveshje mes ortakëve, por në vijim ai ka qenë gjithashtu pjesë e vendimit të gjykatës nr. ***, datë 4.2.2013 i cili është i formës së prerë. Trupi gjykues vlerësoi ti konsideroi ato të ardhura të ligjshme.

60. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kuotës, subjekti ka përfituar vlerat përkatëse nëpërmjet llogarisë bankare, por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues lidhur me pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kuotës.

61. Në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 8, paragrafi f)⁵⁹, të ardhurat nga shitja e kuotave të kapitalit apo të aksioneve janë të tatueshme.

Referuar legjislacionit, e ardhura neto duhet të tatohet me 15 % (10 % për vitin 2014 dhe më parë), por jo çmimi i shitjes së aksioneve apo kuotave. Për këtë qëllim duhet të bëhet diferenca ndërmjet çmimit të shitjes së kuotës së kapitalit dhe vlerës që ka pasur kuota e kapitalit, duke parë bilancet, për të identifikuar vlerën e kapitalit, vlerën e kuotave nëse ka qenë i ndarë në kuota, më pas të llogaritet vlera e 25 % të kuotës së kapitalit dhe kjo t’i zbritet çmimit të shitjes sipas kontratës të 25 % të kuotës. Nëse vlera del pozitive, tatohet me 10 %, referuar normës së tatimit në vitin 2013.

62. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor nëse bashkëshorti i saj kishte detyrimin për të paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kuotës, në vlerën përkatëse dhe nëse ishte paguar ky tatim.

63. Trupi gjykues, arsyeton se nisur nga fakti që shoqëria ka bërë ndër vite rritje të kapitalit të saj, po ashtu gjatë hetimit ka rezultuar se vlera e pasurive/aseteve të shoqërisë ka qenë e konsiderueshme dhe likuidimi i vlerës së kuotës nuk është kryer plotësisht, por vetëm një pjesë, të ardhurat e përfituara në vlerën 2.648.500 (dy milion e gjashtëqind e dyzetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, deri në datën 31.12.2018, duhet të merren në konsideratë në analizën ekonomike të kryer nga Komisioni, si e ardhur e ligjshme.

64. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se të ardhurat e deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit (vitet 2002-2012) të përfituara nga veprimtaria tregtare e bashkëshortit nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Gjithashtu, mbetet e paprovuar se të ardhurat e pretenduara janë shpërndarë dhe se bashkëshorti i subjektit i ka përfituar ato.

65. Në analizë financiare të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një situatë financiare negative në vlerën totale 21.123.695 (njëzetë e një milion e njëqind e njëzetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

66. Përfundimet e mësipërme u vlerësuan të mjaftueshme nga trupi gjykues për të konkluduar mbi kriterin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe se çdo përfundim tjetër lidhur me shkaqet e tjera të kalarua subjektit me cilësinë e barrës së provës nuk do të mund ta çonte në një vlerësimi të ndryshëm për zgjidhjen e çështjes.

67. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.

⁵⁹ “f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksoiner zotëron dhe ia shet një personi tjetër”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin D, pika 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Malo, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë në datën 7.11.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Kryesuese
Xhensila PINE

Relatore
Valbona SANXHAKTARI

Anëtar
Roland ILIA

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro

Shënim: Ky vendim është zbardhur me vonesë për arsye të situatës së rezultuar nga tërmeti i datës 26.11.2019.